



BULETIN

3— MUJOR/NR.

PRILL - QERSHOR 2007

PASQYRA E TITUJVE KRYESORË :

1. RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË QYTETARËVE
2. AVOKIMI NË MBROJTJE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT
3. NGRITJE KAPACITETESH DHE VEPRIMTARI TRAJNUESE NË FUSHËN PENITENCIARE
4. ADRESIMI I PROBLEMEVE PËR TË DREJTAT E NJERIUT TE INSTITUCIONET SHTETËRORE
5. RRRITJA E NDËRGJEGJËSIMIT DHE E EDUKIMIT TË PUBLIKUT
6. FORCIMI I BASHKËPUNIMIT ME SHOQËRINË CIVILE PËR NJË LOBIM MË TË MIRË
7. ZHVILLIMI INSTITUCIONAL I ORGANIZATËS
8. PROJEKTE TË REJA TË KSHH-SË
7. AVOKIMI NË MBROJTJE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT
8. ZHVILLIMI INSTITUCIONAL I OPRGANIZATËS

Përgatiti buletin: av. Klesta Alikaj, juriste/koordinatore projekti

Redaktimi letrar: Marie Mato

KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

BULETIN

Prill-Qershor 2007

Ky botim përgatitet në kuadër të transparencës me publikun dhe mundësohet me mbështetjen financiare të CORDAID-it (CATHOLIC ORGANISATION FOR RELIEF AND DEVELOPMENT)

KSHH-ja vëzhgon respektimin e të drejtave të emigrantëve shqiptarë në Greqi

Në datat 27-30 maj 2007, një grup përfaqësues i Komitetit Shqiptar të Helsinkit organizoi një vizitë në Athinë. Qëllimi i vizitës ishte vendosja e kontakteve me shoqatat e emigrantëve shqiptarë në Greqi, vëzhgimi dhe diskutimi i disa problemeve të të drejtave të njeriut që shqetësojnë komunitetin shqiptar në Greqi, me autoritetet vendëse dhe përfaqësuese shqiptare në Greqi. Në këtë kuadër, përfaqësuesit e KShH-së organizuan takime me shoqatat e emigrantëve shqiptarë në Greqi, si dhe me përfaqësues të medias shqiptare dhe greke në Greqi.

Vazhdon në faqen 2

Konsensusi në zgjedhjen e presidentit - element i rëndësishëm i demokracisë në Shqipëri

Duke vlerësuar rëndësinë e procesit të zgjedhjes së presidentit të Republikës së Shqipërisë, si kryetar shteti dhe përfaqësues i unitetit të popullit, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së publikut dhe të shoqërisë civile në rritjen e rolit të tyre në zhvillimin e demokracisë dhe forcimin e shtetit të së drejtës, më 11 maj 2007, përfaqësues të disa grupeve të shoqërisë civile, përfaqësues të akademikëve dhe Konferenca e Rektorëve të Universiteteve të Shqipërisë nënshkruan një promemorie.

Vazhdon në faqen 11

Komiteti Shqiptar i Helsinkit hap klinikë ligjore falas

Sipas vëzhgimeve të organizatave të të drejtave të njeriut, mes tyre edhe të KShH- së, shërbimi avokator falas në Shqipëri lë për të dëshiruar si në cilësi, ashtu edhe në shtrirjen e shërbimeve që ofrohen. Nisur nga kjo e fundit dhe nga kërkesat e adresuara nga qytetarët, KShH-ja, falë mbështetjes financiare të Komitetit Suedez të Helsinkit, ndërmori nismën e *hapjes së një klinike ligjore për ofrimin e shërbimit avokator falas* në fushën penale, kryesisht për njerëzit në nevojë të cilëve u janë cenuar të drejtat dhe që nuk kanë mundësi financiare për të përballuar vetë shpenzimet e avokatit.

Vazhdon në faqen 14

Për më shumë informacion, mund të na kontaktoni në adresën:

KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT

Rr. Gjin Bue Shpata, pall. 5/1,
ap. 4, Tiranë, P.O Box nr. 1752
web-site: www.ahc.org.al

Tel: 04 233671
Cel: 068 20 23699;
E-mail: office@ahc.org.al

1. RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË QYTETARËVE

1.1 Misione vëzhgimi

Situata e të drejtave të të paraburgosurve pas kalimit në varësi të Ministrisë së Drejtësisë

Në kuadër të misionit të tij mbrojtës dhe sensibilizues për të drejtat e njeriut, gjatë muajve mars-maj 2007, KShH-ja realizoi një raund misionesh monitorimi në burgje dhe në institucionet e paraburgimit. Qëllimi i tyre ishte monitorimi i respektimit të të drejtave të të paraburgosurve pas kalimit të vendeve të paraburgimit në varësi të Ministrisë së Drejtësisë. Në përfundim të vëzhgimeve, KShH-ja ka vënë në dijeni institucionet kryesore përgjegjëse për situatën e të drejtave të njeriut në burgje dhe paraburgime lidhur me gjetjet e këtyre monitorimeve, arritjet e realizuara dhe shkeljet e konstatuara. Gjithashtu, KShH-ja ka dhënë sugjerime dhe rekomandime konkrete për përmirësimin e situatës së të drejtave të të paraburgosurve në këto institucione.

KSHH-ja vëzhgon respektimin e të drejtave të emigrantëve shqiptarë në Greqi

Në datat 27-30 maj 2007, një grup përfaqësues i Komitetit Shqiptar të Helsinkit organizoi një vizitë në Athinë. Qëllimi i vizitës ishte vendosja e kontakteve me shoqatat e emigrantëve shqiptarë në Greqi, vëzhgimi dhe diskutimi i disa problemeve të të drejtave të njeriut që shqetësojnë komunitetin shqiptar në Greqi, me autoritetet vendëse dhe përfaqësuese shqiptare në Greqi. Në këtë kuadër, përfaqësuesit e KShH-së organizuan takime me shoqatat e emigrantëve shqiptarë në Greqi, me ambasadën shqiptare në Athinë, me përfaqësues të medias shqiptare dhe greke në Greqi. Sipas vëzhgimeve të organizatave të të drejtave të njeriut, mes tyre edhe të KShH-së, shërbimi avokator falas në Shqipëri lë për të dëshiruar si në cilësi, ashtu edhe në shtirirjen e shërbimeve që ofrohen. Nisur nga kjo e fundit dhe nga kërkesat e adresuara nga qytetarët, KShH-ja, falë mbështetjes financiare të Komitetit Suedez të Helsinkit, ndërmori nismën e *hapjes së një klinike ligjore për ofrimin e shërbimit avokator falas* në fushën penale, kryesisht për njerëzit në nevojë të cilëve u janë cenuar të drejtat dhe që nuk kanë mundësi financiare për të përballuar vetë shpenzimet e avokatit. Për më shumë informacion shihni: <http://ahc.org.al/kshh/emigrantet/emigrantet2.html>

2. AVOKIMI NË MBROJTJE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

2.1 Ofrim ekspertize në fushën e legjislacionit dhe zbatimit të tij

2.1.1 Oponenca ligjore

KSHH-ja në mbrojtje të lirisë së shtypit

Në kuadër të misionit të tij mbrojtës të të drejtave të njeriut, në maj 2007, KShH-ja i dërgoi një letër Kuvendit të Shqipërisë ku i sugjeronte rishikimin e nenit 159 të Kodit të procedurës penale, paragrafi 3 i të cilit bie ndesh me frymën e Kushtetutës së Shqipërisë, Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe me praktikën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut lidhur me parimin e mbrojtjes së lirisë së shtypit. Për më shumë shih adresën: <http://ahc.org.al/kshh/ARKIV/2007/2206shtypi.htm>

Oponencë ligjore për projektligjin “Për përgjegjësinë e personave juridikë”

Gjatë muajit maj 2007, KShH-ja ka dhënë mendimin e vet për projektligjin “Për përgjegjësinë e personave juridikë”. Duke qenë se përvoja e Shqipërisë në këtë fushë është e kufizuar, projektligji paraqiste disa çështje të diskutueshme për të cilat Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka bërë komentet e tij dhe ia ka dërguar Kuvendit të Shqipërisë. Projektligji u vlerësua duke marrë për bazë Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, ratifikuar me ligjin nr. 9492, datë 13.3.2006 dhe Kodin penal të Republikës së Shqipërisë.

Oponencë ligjore për projektligjin “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”

Gjatë muajit maj 2007, Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka dërguar pranë Kuvendit të Shqipërisë komentet e tij për projektligjin “Për organizimin e pushtetit gjyqësor”. Përveç mendimeve për çështje të diskutueshme dhe delikate që përmbante projektligji, KShH-ja ka sugjeruar që ky projektligj të bëhej objekt diskutimi dhe debati në një rreth më të gjerë të specialistëve të fushës kushtetuese, proceduralo-penale dhe administrative duke përfshirë edhe ekspertë të pavarar nga shoqëria civile, para miratimit nga komisionet përkatëse ose nga seanca plenare e Kuvendit të Shqipërisë. Kjo, për rëndësinë e veçantë që ka ky ligj dhe për problemet e shumta që has drejtësia në Shqipëri.

Sugjerime për hartimin e një politike për kujdesin shëndetësor në sistemin penitenciar shqiptar me fokus të veçantë në sëmundjet ngjitëse

Nisur nga problematika dhe sfidat për kujdesin shëndetësor dhe trajtimin e sëmundjeve ngjitëse në institucionet penitenciare shqiptare, KShH-ja dhe ekspertë të huaj të angazhuar nga ky komitet në këtë fushë ofruan sugjerime dhe mendime për Ministrinë e Drejtësisë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve lidhur me hartimin e një politike për kujdesin shëndetësor në sistemin penitenciar shqiptar me fokus të veçantë në sëmundjet ngjitëse. Në këtë dokument të rëndësishëm ekspertët trajtuan rëndësinë e kësaj strategjie, hapat konkretë që duhen ndërmarrë për të hartuar një strategji të tillë duke marrë parasysh situatën në institucionet shqiptare si edhe strukturat/organet që mund të përfshihen në procesin e hartimit të kësaj politike. KShH-ja mirëpret hartimin e një strategjie të qartë në këtë fushë.

2.1.2 Ofrim ekspertize dhe pjesëmarrje në grupe pune

Pjesëmarrje në grupin e punës për zbatimin e rekomandimeve të Komisionit European kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI)

Për të rritur rolin e KShH-së në zbatimin e rekomandimeve të institucioneve ndërkombëtare dhe mekanizmave monitorues të tyre në fushën e antidiskriminimit dhe tolerancës, gjatë periudhës prill-qershor 2007, KShH-ja ka qenë aktiv me pjesëmarrjen e tij në grupet e punës të ngritura nga Ministria e Punëve të Jashtme lidhur me zbatimin e rekomandimeve të ECRI-së në Shqipëri. Në këtë kuadër, Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka shprehur opinionin e tij për zbatimin e rekomandimeve të ECRI-së për reformën ligjore në drejtim të mosdiskriminimit, trajtimin e azilkërkuësve, të drejtat e minoriteteve në përgjithësi dhe të komunitetit rom dhe atij egjiptian në veçanti. Opinionet e dhëna nga KShH-ja janë bazuar në përfundimet e dala gjatë aktivitetit të tij në fushat përkatëse. Në takimet e grupit të punës merrnin pjesë përfaqësues të institucioneve të ndryshme shtetërore, përfaqësues të grupeve të minoriteteve dhe të organizatave të të drejtave të njeriut që punojnë në fushën e minoriteteve dhe të antidiskriminimit.

Takime të tilla vlerësohen si të dobishme për koordinimin e nismave në fushën e antidiskriminimit dhe të tolerancës dhe në rritjen e rolit të shoqërisë civile në këtë drejtim.

Pjesëmarrje në takimin e punës për reformën në Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut

Në kuadër të reformimit të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, Ministria e Punëve të Jashtme ka realizuar disa takime me ekspertë të fushës. Në këtë kuadër është ngritur Grupi i të Urtëve të cilët kanë dhënë mendimet e tyre për reformimin e kësaj gjykate. Edhe KShH-ja ka marrë pjesë në një takim të tillë për të dhënë mendimin e vet për këtë proces.

Pjesëmarrje në grupin e punës lidhur me zbatimin e rekomandimeve të Komitetit për Parandalimin e Torturës (KPT)

Gjatë periudhës prill-qershor 2007 KShH-ja ka marrë pjesë në grupet e punës të ngritura me nismën e Ministrisë së Punëve të Jashtme lidhur me zbatimin e rekomandimeve të Komitetit për Parandalimin e Torturës (KPT). Në këtë kuadër janë realizuar disa takime të zyrës së përfaqësuesit ligjor në MPJ dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile në të cilat, ndër të tjera, është diskutuar për angazhimin e këtyre të fundit për të dhënë ndihmesën e tyre në zbatimin sa më të shpejtë të këtyre rekomandimeve nga ana e organeve përgjegjëse shtetërore.

Në takimet e grupit të punës është diskutuar ecuria e masave të ndërmarra nga përfaqësuesit e strukturave përgjegjëse shtetërore në vijimësi të sugjerimeve të parashtruara nga përfaqësuesit e shoqërisë civile në takimet pararendëse të punës. KShH-ja, si një aktor në këtë fushë, ka shprehur shqetësimet dhe rekomandimet e veta lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut.

Takimi i ekspertëve për kushtet e personave të paraburgosur

Në datat 22-23 maj 2007, Këshilli i Europës, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, organizuan takimin e ekspertëve për ecurinë e procesit të kalimit të dhomave të paraburgimit në varësi të Ministrisë së Drejtësisë si edhe problematikën që e karakterizon këtë proces. Në takim morën pjesë edhe ekspertë të shoqërisë civile që operojnë në këtë fushë. KShH-ja bëri një prezantim të gjithë problematikës së vërejtur në vendet e paraburgimit që kanë kaluar në varësi të DPB-së, si edhe të ndihmesës që ka dhënë KShH-ja për temat që u trajtuan në tryezë. Gjithashtu, KShH-ja ftoi ekspertët e Këshillit të Europës që në të ardhmen të bashkërendojnë përpjekjet në fushën e dhënies së ekspertizës për reformën ligjore penitenciare.

Takim i grupit të reformës në burgje


Më 25 maj 2007 u mblodh grupi i reformës në burgje, i koordinuar nga Konsorciumi Ndërkombëtar, ku KShH-ja është anëtar. Në këtë takim u diskutuan çështje lidhur me trajtimin e grupeve të veçanta, si: të moshuarit, të sëmurët etj., problemet që lidhen me shoqërimin në gjykata të të paraburgosurve etj. KShH-ja solli në vëmendje të pjesëmarrësve problematikën e vëzhguar për këto çështje konkrete. Gjithashtu, KShH-ja dhe Këshilli i Europës prezantuan veprimtaritë e tyre në fushën penitenciare për vitin 2007-2008. Ky grup pune doli me rekomandime konkrete për problematikën e trajtuar.

2.2 Këshillime ligjore

Gjatë periudhës janar-mars 2007, në adresë të KShH-së kanë ardhur gjithsej 73 ankesa dhe kërkesa për këshillim ligjor. Pjesa më e madhe e tyre ka ardhur nga persona të paraburgosur dhe

të dënuar me burgim. Ankesat e tyre kanë qenë kryesisht për vendimet e gjykatës. Vihet re rritja e numrit të ankesave për shkeljen e të drejtave nga administrata e burgjeve, si edhe e ankesave për kushte të këqija në vendet e paraburgimit dhe burgjet. Në pjesën më të madhe të rasteve, KShH-ja u është adresuar organeve kompetente, si Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, prokurorive përkatëse të rretheve, drejtorisë së policisë etj. Pjesa më e madhe e ankesave janë trajtuar nga Klinika Ligjore. Bazuar në informacionin e marrë dhe nevoja e verifikimeve, janë ndërmarrë 13 misione verifikimi të ankesave të ardhura pranë KSHH-së.

Tabela e ankesave adresuar KSHH-së gjatë periudhës Prill-Qershor 2007



3. NGRITJE KAPACITETESH DHE VEPRIMTARI TRAJNUESE NË FUSHËN PENITENCIARE

Trajnim i personelit të rolit bazë dhe përfaqësues të sektorit civil në institucionin e paraburgimit në Lezhë

Në datat 12-13 prill 2007, në mjediset e institucionit të paraburgimit në Lezhë, KShH-ja organizoi sesionin e katërt trajnues¹ me personelin e rolit bazë me uniforme të regjimit të brendshëm dhe me përfaqësues të personelit civil, si ai mjekësor, punonjës socialë dhe edukatorë. Objektivat kryesorë të sesionit trajnues kishin të bënin me çështje të rëndësishme për mirëmenaxhimin e institucioneve penitenciare të tilla, si: trajtimi i përshtatshëm i personave të dobët², kontaktet me botën jashtë dhe programet ditore në seksionin e paraburgimit në Lezhë. Ekspertët z. Jan van den Brand dhe z. Cees Boeij³, ofruan ekspertizën dhe përvojën e tyre në këtë sesion.

Pjesëmarrësit u pajisën me njohuri të vlefshme për kategori të ndryshme të grupeve të dobëta në institucionet penitenciare dhe tiparet kryesore të sjelljeve të tyre. Në këtë sesion u

¹ Ky aktivitet është pjesë e trajtimeve që KShH-ja po realizon gjatë periudhës 2006-2007 me administratën e institucionit të Lezhës. Qëllimi kryesor me këtë veprimtari është të krijohet një model mirëmenaxhimi i sistemit të paraburgimit në vendin tonë.

² Të dobët si rrjedhojë e moshës, gjinisë, kombësisë, gjuhës, fesë, bindjeve politike, gjendjes fizike dhe mendore, varësisë, llojit të krimit të kryer, llojit dhe gjatësisë së dënimit me burgim.

³ Të dy ekspertët janë drejtorë të përgjithshëm në Shërbimin e Burgjeve Holandeze.

theksua nevoja e mbrojtjes në mënyrë të diferencuar e grupeve të dobëta në përputhje me problemet e tyre si edhe kualifikimi dhe trajnimi i personelit që punon me këtë kategori të paraburgosurish. Temë e trajtuar në këtë sesion trajnues ishte edhe ajo lidhur me të drejtën e personave të dënuar me heqje lirie për të pasur kontakte me botën jashtë. Në përfundim të sesionit trajnues u dhanë rekomandime të cilat i janë përcjellë DPB-së dhe institucionit të paraburgimit Lezhë.

Për më shumë, shih: http://ahc.org.al/kshh/burgjet/kapacitet_administrta.html

Finalizimi i sesioneve trajnuese me administratën e institucionit të paraburgimit në Lezhë

Në datat 31 maj - 1 qershor 2007, në mjediset e institucionit të paraburgimit në Lezhë, KShH-ja organizoi sesionin e pestë dhe të fundit trajnues⁴ me administratën e këtij institucioni. Temat kryesore të sesionit ishin: hartimi i protokolleve specifike për situata të rënda në institucion, hartimi i programeve të veçanta ditore për kategori të ndryshme të paraburgosurish me fokus të veçantë të miturit si edhe dhënia e rekomandimeve për projektet e punësimit të hartuara nga stafi i burgut të Lezhës. Grupi synues i sesionit ishte: stafi i nivelit të lartë dhe të mesëm menaxhues i regjimit të paraburgimit duke përfshirë shefat e personelit civil dhe me uniformë dhe të gjithë përfaqësuesit e sektorit të edukimit të këtij paraburgimi⁵. Ekspertët z. Jan van den Brand dhe z. Cees Boeij⁶ ofruan ekspertizën dhe përvojën e tyre në këtë sesion.

Pjesëmarrësit, të ndarë në grupe pune, hartuan një tip protokoll i cili do të përdoret në institucionin e Lezhës në rast të situatave të ndryshme lidhur me vetëvrasjet. Gjithashtu, ata punuan edhe për hartimin e tri propozimeve të ndryshme për përmirësimin e programit ditor të institucionit të paraburgimit në Lezhë që u diskutuan dhe u komentuan edhe nga ekspertët pjesëmarrës. Për më shumë, shih në adresën:

http://ahc.org.al/kshh/ARKIV/2007/2806sesioni_lezha.htm

4. ADRESIMI I PROBLEMEVE PËR TË DREJTAT E NJERIUT TE INSTITUCIONET SHTETËRORE

4.1 Takime me autoritetet shtetërore

Në një takim zyrtar me drejtorin e përgjithshëm të Burgjeve, KShH-ja prezanton fillimin e projekteve të reja të tij

Më 27 prill 2007, një grup përfaqësues i KShH-së mori takim me z. Saimir Shehri, drejtor i përgjithshëm i Burgjeve dhe me stafin e tij të ngushtë drejtues. Në takim u prezantuan dy projektet e reja që KShH-ja ka filluar të zbatojë, falë mbështetjes financiare të Delegacionit të Bashkimit Evropian në Tiranë dhe UNICEF-it. Të dyja këto nisma gjetën mbështetjen e plotë të z. Shehri dhe të institucionit të tij. Ndër të tjera u diskutua edhe problematika që shqetëson procesin e marrjes në varësi të institucioneve të paraburgimit në vendin tonë si edhe sugjerimet e KShH-së për garantimin e të drejtave të personave të paraburgosur në këto institucione.

⁴ Ky takim është realizuar në kuadër të projektit “Drejtimi i Paraburgimit nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut” financuar nga Fond i Demokracisë dhe të Drejtave të Njeriut, Departamenti i Shtetit, Sh. B. A..

⁵ Me këtë sesion trajnues, KShH-ja finalizoi raundin e trajnimeve që KShH-ja zhvilloi me administratën e institucionit të paraburgimit në Lezhë gjatë vitit 2006-2007. Qëllimi kryesor i kësaj veprimtarie ishte krijimi i një modeli mirëmenaxhimi të sistemit të paraburgimit në vendin tonë.

⁶ Të dy drejtorë të përgjithshëm në shërbimin e burgjeve holandeze.

KSHH-ja paraqet shqetësimet e tij për respektimin e të drejtave të shtetasve shqiptarë gjatë kalimit të kufirit⁷

Në muajin prill 2007, përfaqësues të Komitetit Shqiptar të Helsinkit realizuan një takim pune me z. Gazmend Barbullushi ku parashtruan shqetësimet për trajtimin e shtetasve shqiptarë që ndalohen në Kroaci për kalim të paligjshëm me destinacion Slloveninë dhe Italinë. Gjithashtu, u diskutua edhe për ankesat që kanë ardhur pranë KShH-së lidhur me trajtimin e të burgosurve shqiptarë në burgjet greke⁸. Në këtë takim përfaqësuesit e KShH-së diskutuan edhe për çështje të tjera të ngritura pranë këtij komiteti nëpërmjet ankesave të ardhura nga qytetarët.

KSHH-ja lobon pranë autoriteteve të larta shtetërore për të mos votuar kandidaturën e Bjellorusisë në Këshillin e të Drejtave të Njeriut

Me rastin e zhvillimit të mbledhjes së radhës të Këshillit të të Drejtave të Njeriut, më 3 maj 2007, Komiteti Shqiptar i Helsinkit u ka dërguar letër autoriteteve të larta shtetërore në Shqipëri për të mos votuar kandidaturën e Bjellorusisë për t'u bërë anëtare e Këshillit të të Drejtave të Njeriut, strukturë e Kombeve të Bashkuara. Kjo ka qenë një thirrje e cila u është drejtuar autoriteteve të larta shtetërore nga Komitetet e Helsinkit të vendeve përkatëse, duke argumentuar arsyen përse Bjellorusia nuk duhej të anëtarësohej pranë këtij Këshilli. Argumentet kryesore lidheshin me mospërbushjen e kriterëve të një vendi demokratik ku respektohen të drejtat e njeriut.

KSHH-ja adreson pranë Ministrisë të Drejtësisë probleme që lidhen me fushën penitenciare

Më 8 maj 2007, përfaqësues të KShH-së morën takim me z. Ilir Rusmali, ministër i Drejtësisë dhe znj. Enkeledi Hajro, drejtoreshë e përgjithshme e Çështjeve të Drejtësisë. Në këtë takim u diskutuan anët pozitive të kalimit të sistemit të paraburgimit në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, problemet që janë vëzhguar nga KShH-ja në këtë drejtim, ecuria e disa akteve normative si VKM "Për organizimin e punësimit dhe shpërblimin e të dënuarve, norma ushqimore", sugjerimet për një politikë për parandalimin, kontrollin dhe trajtimin e sëmundjeve ngjithëse në institucionet penitenciare etj.

Gjatë këtij takimi u prezantuan dy projektet e reja që do të fillojnë në fushën e trajnimit të administratës së paraburgimit dhe të burgjeve, mundësuar financiarisht nga Delegacioni i Bashkimit Europian në Tiranë dhe UNICEF-i. Të dyja këto nisma gjetën mbështetjen e plotë të ministrit të Drejtësisë dhe të institucionit të tij.

KShH-ja vendos urat e bashkëpunimit me Drejtorinë e Policisë në kuadër të klinikës ligjore

Më 9 maj 2007, përfaqësues të KShH-së realizuan një takim me drejtorin e përgjithshëm të Policisë së Shtetit lidhur me zbatimin e MSA-së si edhe për vendosjen e urave të bashkëpunimit në kuadër të ofrimit të shërbimit ligjor falas dhe verifikimin e ankesave konkrete. Përveç KShH-së, në takim mori pjesë edhe përfaqësues i Qendrës Rome për Vizionin Bashkëkohor. Përfaqësuesit e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë shprehën gatishmërinë e tyre për të bashkëpunuar me Komitetin Shqiptar të Helsinkit në denoncimin dhe verifikimin e rasteve të ardhura pranë tij. Gjithashtu, takimi shërbeu për të vendosur kontaktet dhe mundësitë e bashkëpunimit ndërmjet organizatës Rome dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë me qëllim marrjen e takimeve dhe referimin e rasteve të shkeljes së të drejtave të njeriut në këtë institucion.

⁷ Ky takim është realizuar në kuadër të projektit "Monitorimi i respektimit të të drejtave të emigrantëve shqiptarë dhe personave të kthyer", mbështetur financiarisht nga Komiteti Norvegjez i Helsinkit.

⁸ Ky problem është ngritur edhe në takimet që KShH-ja ka realizuar në Athinë, Greqi.

Panairi 2008 në IEDP-në në rrugën “Ali Demi”, në Tiranë

Më 18 maj 2007, IEDP-ja në rrugën “Ali Demi” organizoi Panairin 2008, duke vazhduar kështu një traditë të mirë të bashkëjetesës dhe të respektimit të kulturës së zonave të ndryshme nga vinin gratë e dënuara me burgim. Përfaqësuese e KShH-së në këtë veprimtari ishte znj. Edlira Papavangjeli, koordinatore programesh.

Në vijim të kësaj veprimtarie, znj. Papavangjeli u prononcua për gazetën “Shqip” lidhur me problemet që janë vënë re me gratë e dënuara në këtë burg si edhe për vonesën e hyrjes në fuqi të VKM-së “Për organizimin e punësimit në burgje dhe mënyrën e shpërblimit të të dënuarve të punësuar”.

4.2 Komunikimi me autoritetet shtetërore

Gjatë periudhës prill-qershor 2007, KShH-ja ka pasur një komunikim të vazhdueshëm me autoritetet shtetërore. Komunikimi ka qenë kryesisht në kuadër të trajtimit të letrave dhe të ankesave, adresimi i problemeve të të drejtave të njeriut që KShH-ja ka nxjerrë gjatë vëzhgimeve, dhënie mendimesh në kuadër të draftimit të ligjeve etj.

Në përgjithësi vihet re një rritje e ndjeshmërisë së autoriteteve shtetërore në marrjen në konsideratë të kërkesave dhe të rekomandimeve që KShH-ja u ka dërguar.

5. RITJIA E NDËRGJEGJËSIMIT DHE E EDUKIMIT TË PUBLIKUT DHE ADMINISTRATËS PUBLIKE

5.1 Tryeza të rrumbullakëta

Përdorimi sistematik dhe i njësuar i sistemit të lejeve në institucionet e ekzekutimit të dënimeve me burgim

Më 7 qershor 2007, KShH-ja organizoi një tryezë të rrumbullakët për sistemin e lejeve në institucionet e ekzekutimit të dënimeve me burgim⁹. Qëllimi i tryezës ishte diskutimi i kësaj teme dhe hartimi i disa rekomandimeve kryesore për garantimin e funksionimit sa më normal, të njësuar dhe sistematik të lejeve. Ekspertët e ftuar sollën modelet e disa sistemeve të lejeve të disa vendeve të përparuara si edhe ofruan rekomandime të vlefshme për mirëfunksionimin e sistemit shqiptar të lejeve.

Ndër të tjera, pjesëmarrësit në tryezë u ndalën edhe në ndryshimet e propozuara të ligjit “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim” dhe sugjeruan që këto ndryshime t’u nënshtrohen diskutimeve në rrethe specialistësh me qëllim thithjen e mendimeve më të mira. Në përfundim të tryezës pjesëmarrësit hartuan disa rekomandime të cilat iu bënë të njohura Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

Në tryezë morën pjesë përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve si dhe të gjithë drejtorët e burgjeve shqiptare. Në këtë aktivitet ofruan ekspertizën e tyre ekspertët z. Jan van den Brand¹⁰ dhe z. Peeter Naks¹¹.

Ndihmesa e KShH-së në forcimin e bashkëpunimit të shoqatave rome¹²

⁹ Ky aktivitet u realizua në kuadër të projektit të KShH-së “Drejtimi i paraburgimit nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut”, financiar nga Fondi i Demokracisë dhe i të Drejtave të Njeriut, Departamenti i Shtetit, Sh B A.

¹⁰ Ekspert ndërkombëtar me përvojë të gjatë në fushën penitenciare.

¹¹ Ekspert nga misioni i EURALIUS-it në Shqipëri.

¹² Ky aktivitet është realizuar në kuadër të projektit “Monitorimi i respektimit të të drejtave të njeriut dhe zhvillimi institucional”, mbështetur financiarisht nga CORDAID-i.

Me rastin e 16-vjetorit të krijimit të organizatave të romëve të Shqipërisë, Bashkimi Demokratik i Romëve të Shqipërisë (BDRSH) organizoi konferencën me temë “Koha për mirëkuptim – hapësirë për të gjithë”. Konferenca synonte të diskutonte për punën e shoqatave romë, të shoqatave të tjera vendëse, të huaja dhe institucionet shtetërore, përgjithësimin e përvojave për të pasur një bashkëpunim dhe koordinim më të mirë ndërmjet tyre të programeve për minoritetin rom.

Për organizimin e këtij aktivitetit dha ndihmesën e vet edhe KShH-ja. Gjithashtu, drejtorja ekzekutive mbajti një fjalim për rëndësinë e mirorganizimit të shoqërisë civile në përgjithësi dhe të organizatave romë në veçanti, në punën e tyre për minoritetin rom. Me këtë rast, në aktivitet u prezantua edhe botimi më i fundit i KShH-së “Studim i politikave për minoritetet dhe strategjitë e financimit në Shqipëri”.

Lobimi i shoqërisë civile në mbrojtje të lirisë së medias¹³

Më 11 prill 2007, në mjediset e hotel “Tiranës”, organizata “Mjaft” zhvilloi një tryezë të rrumbullakët me përfaqësues të medias dhe aktorë të ndryshëm të shoqërisë civile. Qëllimi i kësaj tryeze ishte forcimi i rolit që duhet të luajë shoqëria civile në mbrojtje të lirisë dhe të pavarësisë së medias, si pushtet i katërt në një shtet demokratik, nga presioni që i bëhet nga ana e organeve të pushtetit ekzekutiv. Në tryezë pjesëmarrësit diskutuan për ndikimin e politikës dhe të segmenteve të veçanta të saj mbi median e lirë dhe të pavarur si edhe për mënyrat që duhet të ndjekë shoqëria civile për të ruajtur parimin demokratik të moscenimit të pavarësisë së pushtetit të medias, transparencës dhe lirisë së saj. Në këtë takim u diskutua edhe për ndikimet që kanë kontrollet selektive dhe të njëanshme të organeve tatimore ndaj një subjekti të caktuar tregtar.

5.2 Reagime publike të KShH-së

Gjatë periudhës prill-qershor 2007, Komiteti Shqiptar i Helsinkit ka qenë i ndjeshëm ndaj zhvillimeve të ndodhura në shoqërinë shqiptare dhe ka reaguar publikisht nëpërmjet deklaratave për shtyp. Në këto deklarata, ka reaguar për ngjarje të tilla, si: vendosja e eksplozivit në makinën e deputetit E. Braçe, akuzat e bëra ndaj medias nga ana e kryeministrit të Shqipërisë, gjendja në institucionin e paraburgimit në Korçë, bazuar në vëzhgimet e realizuara nga KShH-ja, heqja e antenave të televizioneve “TOP Channel” dhe “Vizion +”, rasti i publikuar nëpërmjet medias për dhunën e ushtruar ndaj dy të rinjve nga ana e policisë greke etj. Vlen të përmendet bashkëpunimi i mirë i KShH-së me organizatat e tjera me të cilat ka dalë edhe në deklarata të përbashkëta për shtyp. Për më shumë, shih në adresën: [HYPERLINK "http://ahc.org.al/kshh/DEKLARATA.html"](http://ahc.org.al/kshh/DEKLARATA.html) <http://ahc.org.al/kshh/DEKLARATA.html>

5.3 Ndërgjegjësimi i publikut nëpërmjet medias

5.3.1 Emision sensibilues për të drejtat e minoritetit rom

Në kuadër të javës së romëve, znj Vasilika Hysi, drejtore ekzekutive e KShH-së, mori pjesë në emisionin “Gruaja romë”, transmetuar nga Televizioni Publik Shqiptar në datën 4 prill dhe ritransmetuar më 5 prill 2007. Në këtë emision, përfaqësuesja e KShH-së trajtoi probleme të ndryshme, si: arsimimin e fëmijëve romë, rritjen e aksesit të minoritetit rom në shërbimet publike, nevojën e bashkëpunimit dhe të koordinimit të përpjekjeve të organizatave romë në përgjithësi dhe atyre të grave në veçanti.

¹³ Ky aktivitet është realizuar në kuadër të projektit “Monitorimi i respektimit të të drejtave të njeriut dhe zhvillimi institucional”, mbështetur financiarisht nga CORDAID-i.

5.3.2 Konferencë për shtyp

Më 14 maj 2007, disa organizata jofitimprurëse, si: Zyra për Mbrojtjen e Konsumatorëve, Qendra për Zhvillim dhe Demokratizim të Institucioneve, Grupi Shqiptar i të Drejtave të Njeriut, Qendra Shqiptare e të Drejtave të Njeriut, ndërmjet tyre edhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit, organizuan një konferencë për shtyp për të bërë publik opinionin e tyre për ligjin “Për turizmin”. Pavarësisht nga qëllimi për përmirësimin e situatës së turizmit në vendin tonë, KShH-ja, së bashku me organizatat partnere, shprehën shqetësimin se ligji “Për turizmin” cenon të drejtën e privatësisë, të mbrojtur nga Kushtetuta e Shqipërisë.

Duke u nisur nga rëndësia e ligjit dhe e cenimit që i bëhet së drejtës kushtetuese të privatësisë së individëve, organizatat partnere iu drejtuan me një shkresë zyrtare presidentit të Republikës së Shqipërisë për t’i sugjeruar mosdekretimin e ligjit të mësipërm dhe rishikimin e tij në përputhje me parimet kushtetuese.

5.3 Fushata ndërgjegjësuere

Pjesëmarrja në fushatën kundër punës së paligjshme dhe shfrytëzimit të fëmijëve¹⁴

Më 12 qershor 2007, me rastin e Ditës Ndërkombëtare kundër Punës së Fëmijëve dhe Shfrytëzimit të tyre, me nismën e Qendrës për Mbrojtjen e Fëmijëve (CRCA), para godinës së Ministrisë së Punëve, të Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta u organizua një manifestim nëpërmjet të cilit kërkohej eliminimi i punës dhe i shfrytëzimit ekonomik të fëmijëve. Përveç KShH-së, kësaj lëvizjeje iu bashkuan edhe organizata të tjera që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe të të drejtave të të miturve në veçanti. Përfaqësues të organizatave pjesëmarrëse vunë theksin në domosdoshmërinë e marrjes së masave të nevojshme nga ana e shtetit për të reduktuar shfrytëzimin ekonomik dhe punësimin e paligjshëm të fëmijëve. Të pranishëm në këtë aktivitet ishin edhe përfaqësues të medias të cilët intervistuan pjesëmarrës të këtij aktiviteti. Për më shumë rreth letrës së hapur, shih www.ahc.org.al

5.4 Botime të reja të KShH-së

Gjatë periudhës prill-qershor 2007 kanë dalë disa botime të KShH-së, si:

Respektimi i të drejtave të të miturve në procesin penal¹⁵

Nëpërmjet këtij studimi është synuar të realizohet vlerësimi i respektimit të të drejtave të të miturve në kontakt me drejtësinë në gjykatat e rretheve gjyqësore Tiranë, Shkodër, Fier, Elbasan, Gjirokastër, Vlorë dhe Korçë për vitin 2005 dhe një pjesë të vitit 2006. Studimi përmban, gjithashtu, edhe përfundimet e dala lidhur me respektimin e të drejtave të të miturve në proceset penale, rekomandime për të nxitur organet politikëbërëse dhe vendimmarrëse për të përshpejtuar masat për një trajtim më të mirë të të miturve në nevojë dhe ndihmesa në përmirësimin e legjislacionit për sistemin e drejtësisë penale për të miturit.

Studim i politikave për minoritetet dhe strategjitë e financimit në Shqipëri¹⁶

¹⁴ Ky aktivitet është realizuar në kuadër të projektit “Rritja e rolit të shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore në promovimin dhe respektimin më të mirë të të drejtave të minoriteteve”, me mbështetjen financiare të CORDAID-it.

¹⁵ Ky botim është realizuar me mbështetjen financiare të CORDAID-it.

Qëllimi i këtij studimi është mbledhja e informacionit bazë për politikat dhe veprimet e të gjithë aktorëve që prekin dhe ndikojnë drejtpërdrejt dhe publikisht komunitetin rom dhe atë egjiptian me qëllim koordinimin më të mirë të tyre.

Ky studim përmban të dhëna për projektet kryesore të zbatuara gjatë periudhës 2003-2005. Gjithashtu, studimi pasqyron politikat dhe veprimet aktuale të ndërmarra nga aktorë të ndryshëm që veprojnë në këtë fushë. Përmes studimit është arritur të mblidhen informacione dhe të krijohet një bazë e thjeshtë të dhënash që lidhen me projektet dhe programet që trajtojnë problemet e komunitetit rom dhe atij egjiptian.

Në këtë kontekst, ky studim do t'i lejojë programet dhe projektet e tjera të fokusohen më mirë në ato drejtime ku nevojitet më shumë vëmendje.

“Vëzhgimi i respektimit të të drejtave të minoriteteve nga bashkia e Korçës”¹⁷

Qëllimi i projektit ishte vlerësimi i respektimit të të drejtave të minoriteteve në nivel vendor dhe evidentimi i mundësive për zhvillimin e tyre. Baza e zbatimit të tij ka qenë anketimi i qytetarëve dhe i administratës së bashkisë së Korçës.

Të gjitha përfundimet e dala nga anketimet e qytetarëve dhe të administratës së bashkisë së Korçës u diskutuan në një tryezë të rrumbullakët të organizuar në qytetin e Korçës dhe janë përfshirë në botimin “Vëzhgimi i respektimit të të drejtave të minoriteteve nga bashkia e Korçës”.

Nëpërmjet këtij botimi, KShH-ja synon të ofrojë përjasje konkrete duke marrë parasysh të veçantat që ofron qyteti i Korçës, pakicat që ekzistojnë në këtë qytet dhe cilësinë e qeverisjes në nivel vendor. Me këtë nismë, krahas vlerësimeve të përgjithshme të situatës së respektimit të të drejtave të pakicave që vetë bashkia ka, KShH-ja kërkon t'u ofrojë organeve të qeverisjes vendore përfundime dhe rekomandime konkrete për situatën dhe përmirësimin e saj në këtë qytet.

6. FORCIMI I BASHKËPUNIMIT ME SHOQËRINË CIVILE PËR NJË LOBIM MË TË MIRË

6.1 KSHH-ja merr pjesë në tryezën e rrumbullakët për respektimin e të drejtave të njeriut në shëndetin mendor

Më 30 prill 2007, Qendra Shqiptare e Rehabilitimit të Traumës dhe të Torturës, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, organizuan tryezën e rrumbullakët me temë “Monitorimi i situatës së respektimit të të drejtave të njeriut në shëndetin mendor”.

Qëllimi i aktivitetit ishte dhënia e një tabloje të përgjithshme për kuadrin aktual ligjor në mbrojtje të shëndetit mendor të individëve. Në këtë drejtim u diskutuan aspekte të veçanta të ligjit “Për shëndetin mendor”, parë në këndvështrimin dhe zbatimin në praktikë të tyre, nisur nga pikëpamja e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. KShH-ja dha mendime për përmirësimin e këtij ligji duke e vlerësuar nga këndvështrimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut, si dhe për nevojën e plotësimit të kuadrit ligjor me akte të tjera nënligjore që mundësojnë zbatimin e tij.

¹⁶ Ky studim është financuar nga CORDAID-i në kuadër të programit “Politikat për minoritetet dhe strategjitë e financimit në Shqipëri”, vënë në zbatim me një ekspert lokal.

¹⁷ Ky studim është realizuar në kuadër të projektit “Monitorimi i respektimit të të drejtave të minoriteteve në bashkinë e Korçës”, mundësuar financiarisht nga Friedrich Ebert Stiftung.

6.2 Konsensusi në zgjedhjen e presidentit - element i rëndësishëm i demokracisë në Shqipëri

Duke vlerësuar rëndësinë e procesit të zgjedhjes së Presidentit të Republikës së Shqipërisë, si kryetar shteti dhe përfaqësues i unitetit të popullit; me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së publikut dhe të shoqërisë civile në rritjen e rolit të tyre në zhvillimin e demokracisë dhe forcimin e shtetit të së drejtës, më 11 maj 2007, përfaqësues të disa grupeve të shoqërisë civile, përfaqësues të akademikëve dhe Konferenca e Rektorëve të Universiteteve të Shqipërisë nënshkruan një promemorie.

Nëpërmjet saj kërkohet që partitë politike të kuptojnë rregullat kushtetuese të zgjedhjes së Presidentit, si domosdoshmëri absolute të gjetjes së konsensusit për cilësitë e procesit dhe të kandidatit deri në zgjedhjen e tij dhe të mos e përdorin këtë moment për përfitime të ngushta partiake, si dhe që procesi i përzgjedhjes së kandidatëve të jetë i gjerë, i hapur, i shtrirë në kohë e jo i momentit të fundit.

Promemoria iu drejtua: znj Jozefina Topalli, kryetare e Kuvendit të Shqipërisë; z. Sali Berisha, kryeministër, kryetar i Partisë Demokratike; z. Edi Rama, kryetar i Partisë Socialiste; kryetarëve të partive të tjera parlamentare dhe të gjithë kryetarëve të grupeve parlamentare.

6.3 Takime të KSHH-së me përfaqësues të organizatave vendëse dhe ndërkombëtare

KSHH-ja vendos ura bashkëpunimi me aktorët e tjerë të shoqërisë civile në kuadër të hapjes së klinikës ligjore falas

Në datat 3 – 4 maj 2007, KShH-ja ndërmoi disa takime me aktorë të ndryshëm të shoqërisë civile. Qëllimi i takimeve ishte njohja e tyre me shërbimet e reja ligjore që KShH-ja do të ofrojë në kuadër të klinikës ligjore të hapur rishtas. Gjithashtu, nëpërmjet tyre, synohej realizimi i përditësimit të informacioneve për situatën e shërbimit ligjor në Shqipëri.

Në këtë kuadër, KShH-ja realizoi takime me përfaqësuesit e organizatës “Amaro Drom”, Prezencën e OSBE-së në Tiranë, Klinikën Ligjore për të Miturit, Zyrën për Mbrojtjen e Qytetarëve, Fondacionin për Personat me Aftësi Fizike të Kufizuara si dhe me Dhomën Kombëtare të Avokatisë.

Takimet e realizuara ndihmuan për rritjen e bashkëpunimit të aktorëve të ndryshëm të shoqërisë civile që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut. Gjithashtu, nëpërmjet tyre u bë një bashkërendim dhe koordinim i rasteve dhe i grupeve të synuara që mbulojnë këto organizata nëpërmjet një marrëveshjeje bashkëpunimi me të gjithë aktorët. Kjo do të ndikojë në rritjen e eficiencës së punës së këtyre organizatave për zgjidhjen e problemeve të paraqitura nga ana e qytetarëve.

Takim me delegacionin irakian lidhur me drejtësinë për të miturit në Shqipëri

Më 21 maj 2007, znj Vasilika Hysi, drejtore ekzekutive e KShH-së, pati një takim me delegacionin irakian i cili erdhi në Shqipëri për një vizitë studimore për drejtësinë e të miturve, organizuar nga zyra e UNICEF-it, Irak (me seli në Aman, Jordani) dhe zyra e UNICEF-it, Tiranë dhe Kosovë. Në këtë takim delegacioni u njoh me përvojën pozitive të KShH-së në fushën e drejtësisë për të mitur dhe në atë të monitorimit të burgjeve në Shqipëri si dhe me reformën në burgje.

Znj. Vasilika Hysi iu përgjigj interesimit të madh të anëtarëve të delegacionit lidhur me rolin e Komitetit Shqiptar të Helsinkit, metodologjinë e punës dhe bashkëpunimin me institucionet shtetërore.

Takim me përfaqësues të Amnesty International për dhunën ndaj grave në Shqipëri

Më 25 qershor 2007, përfaqësues të KShH-së realizuan një takim me përfaqësues të Amnesty International (AI), bazuar në kërkesën e kësaj të fundit. Gjatë takimit u bë një ekspozë e veprimtarisë së KShH-së në fushën e të drejtave të njeriut në Shqipëri, për respektimin e të drejtave të nejrut dhe forcimin e shtetit të së drejtës. Përfaqësuesit e AI-së bënë të njohur qëllimin e projektit të tyre për luftën kundër dhunës ndaj grave në Shqipëri dhe shkëmbyen mendime për të drejtat e grave në vend, arritjet, problematikën dhe sfidat në këtë drejtim, si dhe për kontributin e dhënë nga KShH-ja dhe aktorë të tjerë të shoqërisë civile në Shqipëri. Përfaqësuesja e KShH-së i bëri me dije përfaqësuesit e AI-së për disa rekomandime të vlefshme për përmirësimin e respektimit të grave në vend. Objekt diskutimi ishte edhe bashkëpunimi me AI-në në këtë fushë. Gjatë këtij takimi u diskutua si mund të bëhej më efektiv ky bashkëpunim.

Takim me përfaqësues të Agjencisë Spanjolle për Bashkëpunim Ndërkombëtar për nevojat e institucioneve penitenciare në Shqipëri

Më 26 qershor 2007, KShH-ja mori takim me përfaqësues të Agjencisë Spanjolle për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe ekspertin e saj në fushën penitenciare. Në këtë takim u prezantuan në detaje veprimtaritë e planifikuara të KShH-së, krahas kontributit të dhënë në këtë fushë. Përfaqësuesit e Agjencisë Spanjolle për Bashkëpunim Ndërkombëtar bënë me dije se kjo Agjenci ishte në një mision të nxjerrjes së nevojave në fushën penitenciare me qëllim që eksperti spanjoll të planifikonte ndihmën që mund t'u ofronte qeveria e tij institucioneve penitenciare shqiptare. Ky takim kontribuoi në një koordinim më të mirë dhe efikas të fondeve, të ekspertizës dhe mbështetjes që po i jepet dhe që do të vazhdojë t'u jepet institucioneve shqiptare penitenciare.

Në një takim me shoqërinë civile, KSHH-ja prezanton aktivitetin e vet në fushën penitenciare

Më 27 qershor 2007, misioni EURALIUS e ftoi KShH-në të bënte një prezantim të nismave dhe të veprimtarive të veta në fushën penitenciare, për vitet 2007-2008, në kuadër të programit CARDS dhe atë të mbështetur nga UNICEF-i. Në takim u trajtuan veçanërisht edhe sfidat që mendohet të hasen në këtë fushë. Pjesëmarrësit ishin përfaqësues të EURALIUS-it dhe ekspertë të tij si edhe përfaqësues të organizmave ndërkombëtarë në Shqipëri. KShH-në do ta ftojë edhe në të ardhmen për të përditësuar progresin e bërë në këtë fushë për pjesëmarrësit e këtij takimi. Pjesëmarrësit e vlerësuan takimin të nevojshëm për të kontribuar në një bashkëpunim dhe koordinim më të mirë të aktorëve që operojnë në këtë fushë.

7. ZHVILLIMI INSTITUCIONAL I ORGANIZATËS

7.1 Ngritje kapacitetesh të stafit të KSHH-së

Trajnim për aspekte ligjore dhe menaxherale për shërbimin avokator falas

Më 1 qershor 2007, Komiteti Shqiptar i Helsinkit¹⁸ organizoi një trajnim të stafit të tij për aspekte ligjore dhe menaxherale për shërbimin avokator falas që KShH-ja do të ofrojë.

Çështjet kryesore të trajtuara në këtë trajnim ishin: konceptet bazë për ndihmën ligjore falas; roli dhe specifikat e këshilltarit të ndihmës ligjore falas dhe të avokatëve të klinikës ligjore; llojet e çështjeve që trajtohen dhe të cilave u ofrohet ky shërbim; fazat në të cilat kalojnë ato; trajtimi i problemeve paraligjore dhe ligjore; aspekte të menaxhimit, të administrimit dhe të

¹⁸ Në kuadër të projektit "Për një mbrojtje më të mirë të viktimave të të drejtave të njeriut në Shqipëri", mbështetur financiarisht nga Komiteti Suedez i Helsinkit

financimit të ndihmës ligjore falas etj. Trajnimi u shoqërua edhe me metoda interaktive në të cilat u trajtuan edhe shumë probleme të hasura në praktikë.

Avokatë dhe përfaqësues të tjerë të stafit që punojnë pranë Qendrës së Shërbimit Ligjor Falas në Tiranë (TLAS), ofruan ekspertizë ligjore dhe praktike¹⁹.

7.2 Rekrutim i stafit të ri të KSHH-së

Me qëllim përmirësimit të punës së organizatës, KShH-ja shpalli njoftimin për vendin e lirë të punës në pozicionin e asistentes së financës/administratore e zyrës. Për këtë qëllim u ngrit një komision vlerësues i cili intervistoi kandidaturat e përzgjedhura në listën e shkurtuar të aplikuesve.

Ndër të gjitha kandidaturat e ardhura, si kandidaturën më të përshtatshme për pozicionin asistent financiar/administrator zyre, komisioni përzgjedhi znj. Valmira Kallushi.

Gjithashtu, në kuadër të fillimit të zbatimit të projekteve të reja në fushën penitenciare, pranë KSHH-së është angazhuar znj. Klejda Ngjela, si asistente e këtyre projekteve.

8. PROJEKTE TË REJA TË KSHH-SË

KSHH-JA HAP KLINIKËN LIGJORE FALAS

Sipas vëzhgimeve të organizatave të të drejtave të njeriut, mes tyre edhe të KShH-së, shërbimi avokator falas në Shqipëri lë për të dëshiruar si në cilësi, ashtu dhe në shtrirjen e shërbimeve që ofrohen. Nisur nga kjo e fundit dhe nga kërkesat e adresuara nga qytetarët, KShH-ja ndërmori iniciativën e *hapjes së një klinike ligjore për ofrimin e shërbimit avokator falas* në fushën penale, kryesisht për njerëzit në nevojë, që nuk kanë mundësi financiare për të përballuar vetë shpenzimet e avokatit dhe që janë viktima të abuzimit me pushtetin. Kjo nismë mundësohet falë mbështetjes financiare të Komitetit Suedez të Helsinkit.

Objektivi kryesor i këtij shërbimi është mbrojtja më e mirë e grupeve të cënueshme, të drejtat e të cilave shkelen nga përfaqësuesit e institucioneve shtetërore.

Risia që do të sjellë KShH-ja, përfshin *asistencën ligjore* që u ofrohet qytetarëve për *plotësimin e dokumentacionit për në gjykatë, adresimin e ankesave në institucionet shtetërore kompetente* si dhe, në raste të veçanta të shkeljeve flagrante të të drejtave të njeriut, *përfaqësimin e çështjeve në gjykatë*.

Për herë të parë në Shqipëri ofrohet një shërbim avokator i ri falas për rastet kur përfaqësues të institucioneve shtetërore kanë ushtruar dhunë, torturë dhe trajtime të tjera çnjerëzore, kur kanë diskriminuar si dhe kur kanë shkelur të drejtat e personit për një proces të rregullt gjyqësor. Për më shumë, shih: <http://www.ahc.org.al/kshh/ARKIV/2007/0706klinika.htm>

PROJEKTE TË REJA

KSHH-JA JEP NDIHMESËN E VET PËR NJË DREJTIM HUMAN TË BURGJEVE SHQIPTARE²⁰

Me qëllim përmirësimit të respektimit të të drejtave të personave të paraburgosur dhe të dënuar, rritjen e shkallës së njohurive për të drejtat e njeriut nga administrata e institucioneve penitenciare dhe standardeve të menaxhimit, KSHH-ja, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, fillon zbatimin e programit “**Drejtimi human i burgjeve**”.

¹⁹ KShH-ja ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me këtë qendër (TLAS)

²⁰ Ky projekt realizohet në kuadër të programit CARDS, mbështetur financiarisht nga Bashkimi Evropian

Objektivat kryesorë të programit janë:

- a) Zhvillimi i një sistemi të plotë të përzgjedhjes së personelit në administratën e burgjeve, trajnimi fillestar dhe vazhdues i tij (me fokus të veçantë në institucionet penitenciare që do të hapen së shpejti).
- b) Forcimi i kapaciteteve menaxhuese, funksionale dhe i programeve të formimit fillestar dhe vazhdues të Qendrës së Trajnimit të Burgjeve.
- c) Trajnimi i stafit të nivelit të lartë drejtues në burgje si edhe i grupit të trajnuesve nga administrata e burgjeve lokale.
- d) Rritja e kapaciteteve menaxhuese të personelit të lartë drejtues të institucioneve që do të fillojnë të funksionojnë së shpejti, si ai i Fushë-Krujës, Korçës dhe Vlorës.

Për realizimin e suksesshëm të kësaj nisme është i domosdoshëm përkushtimi, vullneti i mirë dhe angazhimi konkret në të gjitha veprimtaritë e planifikuara i Ministrisë së Drejtësisë, i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, konkretisht i sektorëve përkatës, si dhe i institucioneve të tjera penitenciare, të cilat do të jenë edhe përfituesit e drejtpërdrejtë të të gjitha shërbimeve që ofron ky program.

Në zbatimin e këtij programi do të japin ndihmesën e tyre të çmuar ekspertë me përvojë të gjatë në fushën penitenciare të Shërbimit Holandez të Burgjeve, ekspertë kroatë, ekspertë të KShH-së, si dhe ekspertë nga fusha akademike dhe e praktikës. Gjithashtu, Ministria e Drejtësisë, veçanërisht Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe institucionet penitenciare, do të ofrojnë mbështetjen dhe kapacitetet e tyre të plota përgjatë gjithë procesit.

KSHH-JA KONTRIBUON NË PËRMIRËSIMIN E RESPEKTIMIT TË TË DREJTAVE TË TË MITURVE DHE GRAVE NË INSTITUCIONET PENITENCIARE

Bazuar në përvojën dhe problematikën e hasur lidhur me respektimin e standardeve të të drejtave të njeriut në institucionet penitenciare, veçanërisht në qendrat e paraburgimeve në komisaritet e policisë, KShH-ja ka filluar zbatimin e projektit të ri “Për një respektim më të mirë të të drejtave të të miturve dhe grave në institucionet penitenciare”²¹.

Objektivi kryesor i këtij projekti është të japë ndihmesën e vet në procesin e ndërmarrë nga qeveria shqiptare, në veçanti nga administrata e burgjeve shqiptare, për të krijuar një sistem të pranueshëm të trajtimit të të miturve dhe grave në institucionet penitenciare, për të garantuar respektimin e dinjitetit njerëzor dhe të sigurisë personale të këtyre kategorive të personave të dënuar me heqje lirie. Për më shumë, shih www.ahc.org.al

KSHH-JA DO TË VAZHDOJË TË JAPË NDIHMESËN E VET NË PROMOVIMIN DHE RESPEKTIMIN MË TË MIRË TË TË DREJTAVE TË MINORITETEVE NË SHQIPËRI

Për të garantuar një zbatim më të mirë të legjislacionit vendës dhe ndërkombëtar, si dhe të rekomandimeve të ndërkombëtareve për përmirësimin e respektimit të të drejtave të minoriteteve në përgjithësi dhe atij rom dhe egjiptian në veçanti, KShH-ja ka filluar zbatimin e projektit “Rritja e rolit të shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore në promovimin dhe respektimin më të mirë të të drejtave të minoriteteve”²². Qëllimi i projektit është përmirësimi i vëzhgimit të respektimit të të drejtave të minoriteteve në përgjithësi dhe të të drejtave të minoritetit rom dhe atij egjiptian në veçanti.

²¹ Zbatimi i këtij projekti mbështetet nga UNICEF-i, Shqipëri dhe financohet nga CARDS 2004 dhe SIDA

²² Zbatimi i këtij projekti mundësohet financiarisht nga CORDAID-i

Pjesë e rëndësishme e projektit është vëzhgimi i masave të marra në nivel vendor për përmbushjen e standardeve ndërkombëtare të të drejtave të minoriteteve në qytetet Tiranë, Fier, Elbasan dhe Gjirokastrë, i cili do të realizohet përmes anketimit të qytetarëve dhe administratës bashkiake. Për zbatimin e tij, KShH-ja do të ketë bashkëpunim të ngushtë me qeverisjen vendore të qyteteve përkatëse. Gjithëpërfshirja e qytetarëve të bashkive në përgjithësi dhe e përfaqësuesve të minoriteteve në veçanti do të jetë element i rëndësishëm për një vlerësim sa më objektiv të gjendjes së të drejtave të minoriteteve në këtë bashki.

Nëpërmjet projektit, KShH-ja do të synojë mobilizimin e organizatave rome dhe atyre egjiptiane për të lobuar në një zë të përbashkët për përmirësimin e respektimit të të drejtave të tyre. Gjithashtu, projekti synon përmirësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor shqiptar në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Bashkëpunimi dhe koordinimi i frytshëm me aktorët e shoqërisë civile, institucionet shtetërore dhe organet e qeverisjes vendore do të jetë kontribut i vlefshëm në përmirësimin e respektimit të të drejtave të minoriteteve në Shqipëri.